



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-06901-69441 dt. 16/12/2021

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”), nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____12.2021, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

- -Kryesues;
- -Koordinator i KKSB-së;
-
-

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësit e KKSB-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 3

Mandati i Këshillit Komunale për Siguri në Bashkësi është katër (4) vjeçar, ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit, si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimin të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i Këshillit Komunale për Siguri në Bashkësi është përcaktuar me nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi themelohet dhe është përgjegjës për; përgatitja e planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi; identifikimi i dukurive negative që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojë planet e veprimi; bashkëpunimi me policinë në parandalimin e veprimeve të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi; bashkëpunimi me institucionet qendrore që merren me sigurinë publike, më qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi; lidhja marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi që i tejkalojnë kufijtë e komunës së tyre; të kërkojë nga Kuvendi Komunal i Komunës, financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; përmes komunës, të kërkojë nga ndonjë organizatë jo qeveritare financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë; fton në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së- DSB; fton përfaqësues nga institucionet qeveritare, të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takime të KKSB-së; kërkon nga policia përgjigje për rastet që janë me rëndësi për sigurinë e bashkësisë, duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore; mbajtja e takimeve të rregullta, ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të këtij udhëzimi administrativ.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-060105-69942 dt. 16/12/2021

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”), nenit 53 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, 7, 8, 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ____12.2021, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM
Për themelimin e Komitetit për Komunitete

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:

1. _____ -Anëtarë;
2. _____ -Anëtarë;
3. _____ -Anëtarë;
4. _____ -Shoqëria Civile;
5. _____ -Komuniteti i biznesit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve të parapara me nenin 53.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 3

Mandati i Komitetit për Komunitete është katër (4) vjeçar ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

 **Kryetari i Komunës**
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i komiteteve të përhershme është përcaktuar me nenin 51 dhe 53 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë.

Komiteti për Komunitete themelohet dhe është përgjegjës për; promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim, dhe bën rekomandimin në Kuvendin e Komunës; shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht; për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor) sigurimin dhe mbrojtjen adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-060/25-69993 dt. 16/12/2021

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”), nenit 51 dhe 52 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, 4, 5, 6 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë ____12.2021, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM
Për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa në këtë përbërje:

1. _____-Kryesues;
2. _____-Anëtarë;
3. _____-Anëtarë;
4. _____-Anëtarë;
5. _____-Anëtarë;
6. _____-Anëtarë;
7. _____-Anëtarë.

Neni 2

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve të parapara me nenin 52.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 3

Mandati i komitetit për Politikë dhe Financa i Kuvendit është katër (4) vjeçar ashtu sikurse anëtarët e Kuvendit si dhe përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të kuvendit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Themelimi i komiteteve të përhershme është përcaktuar me nenin 51 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe me nenin 3 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë.

Komiteti për Politikë dhe Financa themelohet dhe është përgjegjës për; shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik; kornizën vjetore buxhetore afatmesme; planin vjetor të prokurimit; rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat; buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.